



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501302/3

Tiranë ___/___/2015

Lënda: *Kërkohet marrja e masave ndaj punonjësve të IEVP Lezhë për ngjarjen e dt. 15.07.2015*

Drejtuar: Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Artur Zoto

Për dijëni: Ministrit të Drejtësisë
Z. Nasip Naço

TIRANË

Të nderuar,

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), me marrjen në shqyrtim të ankesës së shtetasit M.Gj., i ndodhur i ndaluar në IEVP, Lezhë, është vënë në dijeni nga ana e familjarëve të këtij shtetasi se, ai është keqtrajtuar nga ana e forcave të Policisë së Shtetit gjatë aksionit policor për ndalimin e vrasësit të dyshuar të dy turistëve çekë, në Komunën Rrethina, Qarku Shkodër.

Pas hetimit paraprak dhe shqyrtimit të provave dhe materialeve që lidhen me çështjen, institucioni i Avokatit të Popullit vlerësoi se për qëllime të një hetimi objektiv dhe të thelluar të çështjes ishte e domosdoshme që të kryhej një akt ekspertimi mjeko-ligjor, për dëmtimet e pretenduara nga ana e ankuesit, bazuar në parashikimet e bëra në germën "ç", të nenit 19, të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Mbi këtë bazë Avokati i Popullit i ka kërkuar zyrtarisht me aktin përkatës të datës 14.07.2005, mjekut ligjor z.Petrit Luli, në Spitalin Rajonal Lezhë, të kryej ekspertimin mjeko ligjor ndaj shtetasit M.Gj., i ndodhur në IEVP, Lezhë, duke caktuar edhe detyrat përkatëse për këtë akt ekspertimi.

Ne si institucion kemi qënë në prijte të raportit të përfunduar nga ana e mjekut ligjor, por faktikisht në datën 15.07.2015 jemi vënë në dijeni nga ana këtij të fundit në rrugë elektronike se, nuk është lejuar të kryejë aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, me pretendimin se i mungonte leja e hyrjes nga ana e

Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të hyrë në IEVP, Lezhë, apo autorizimi nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Lezhë.

I nderuar z. Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve,

Ky është rasti i parë dhe i vetëm, që institucioni i Avokatit të Popullit ndalohet përmes personave të autorizuar ligjërish nga ana e tij që të ushtrojë funksionet që i janë dhënë nga Kushtetuta dhe baza ligjore në fuqi. Është tërësisht e papranueshme dhe shkelje flagrante ligjore nga ana e punonjësve të institucioneve të vartësisë që drejtohen nga ana Juaj, që të krijohen të tilla situata dhe të vihet në diskutim autoriteti i një institucioni të krijuar shprehimisht nga ana e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në nenin 19 gërma "a" të ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar, për rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, ka të drejtë:

-Të kryejë hetime në vend, përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve apo dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton.

Po kështu, sikurse parashikohet në nenin 19, gërma "ç" të ligjit nr. 8454, dt. 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar, Avokati i popullit ka të drejtë të kryejnë së të kërkojnë ekspertiza për qëllime dhe në funksion të hetimeve të pavarura rast pas rasti. Cituam këto dy dispozita për të kuptuar se ajo që ka ndodhur me dt 14.07.2015 në IEVP Lezhë, me refuzimin që i është bërë personit të autorizuar ligjërish nga ana e Avokatit të Popullit, për kryerjen e aktit përkatës së ekspertizës Mjeko-ligjore është një cënim serioz që i është bërë autoritetit institucional dhe ligjorë të Avokatit të Popullit. Ky cënim ka rrjedhur si pasojë e shkeljes së rëndë të dispozitave ligjore në fuqi të cilat përcaktojnë pikërisht këtë autoritet të Avokatit të Popullit.

Jo vetëm kaq por refuzimi i që i është bërë mjekut ligjorë të autorizuar në këtë rast nga ana e Avokatit të Popullit evidenton edhe shkelje ligjore të parashikuara në nenin 22/1 të Ligjit për Avokatin e Popullit ku parashikohet shprehimisht se: "Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil".

Në këto kushte besojmë që tre janë shkaqet që kanë çuar në krijimin e kësaj situate; ose punonjësit përgjegjës së IEVP Lezhë nuk njohin ligjin dhe përgjegjësitë e tyre, ose ato janë urdhëruar qëllimisht për të penguar veprimtarinë normale të përfaqësuesve të institucionit të Avokatit të Popullit, ose ata qëllimisht, gjë që është edhe më e rëndë, kanë penguar hyrjen e mjekut ligjor në ambientet e IEVP Lezhë me qëllim që të fshehin gjurmët e dhunës fizike që është ushtruar ndaj shtetasit M.Gj.. Megjithatë këto janë konkluzione të cilat besojmë që do të qartësohen pas një analize konkrete dhe të thellë që drejtoria që ju drejtoni do ti bëjë këtij rasti. Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve tona i deritanishëm vlerësoj se ka qënë shumë korrekt ndaj dhe

kërkojmë që ky rast të merret në shqyrtim dhe të analizohet në një kohë sa më të shpejtë nga ana juaj me dy qëllime kryesore.

1. Marrjen e masave administrative apo dhe penale ndaj punonjësve përgjegjës së IEVP Lezhë të cilët kanë refuzuar dhe nuk kanë lejuar hyrjen e mjekut ekspert ligjor Z.Petrit Luli në IEVP Lezhë, për kryerjen e aktit të ekspertimit Mjeko-ligjorë për shtetasim M.Gj..
2. Mospërsëritjen e rasteve të tilla në veprimtarinë e institucioneve apo stukturave në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në të ardhmen.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni mbas analizimit dhe nxjerrjes së përgjegjësive për këtë rast lutemi të na vini në dijeni në një kohë sa më shpejt të mundshme.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI